

Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim:

## 6 milionë euro për Fondin "Besa", mbështetje për SME



Fondi "Besa" ka nënshkruar dje në Tiranë, një marrëveshje huaje me vlerë 6 miliona euro me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, e cila pritet t'i japë një shtytë të re bujqësisë dhe agrobiznesit. Në këtë eveniment ishin të pranishëm Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, z.Edmond Panariti, Zv/Presidenti i Sektorit Bankar pranë

Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim z.Mustafa Boran, Drejtori Ekzekutiv i Fondit "Besa" z.Bajram Muça, etj. Në një konferencë për mediat, presidenti i këtij Fondit "Besa"

z.Bajram Muça u shpreh se ky fond është i vendosur të rrisë më tej aktivitetin si dhe të vazhdojë të financojë për zhvillimin e zonave rurale. "Ne kemi arritur një performancë të lartë duke rritur

aktivitetin. Do përbushim të gjitha detyrimet nga kjo marrëveshje, shpresojmë që të jetë një fillim i mbarë pasi do vazhdojmë të investojmë për zhvillimin e

(Faqe 5)

## Tatimet: Shkelje dhe penalizime në 404 subjekte turistike

(Faqe 4)



## Qeveria: Duke filluar nga 1 gushti, pensionet rriten 2%

Duke filluar nga data 1 gusht, rreth 606 mijë qytetarë do të përfitojnë pension më të lartë. Vendimi u mor në mbledhjen e djeshme të qeverisë, e cila vendosi të rrisë me 2%, që në vitin e saj të parë, pensionet e plotë, të pjeshme, pensionet e reduktuara, pensionet e parakohshme

të pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe familjare, pensionet për vjetërsi shërbimi, si në qytet ashtu edhe në fshat. Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, z. Erion Veliaj, deklaroi pas mbledhjes së qeverisë se, në të njëjtën masë...

(Faqe 6)

## Banka Botërore, 7.3 milionë Euro për zonat rurale

Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore miratoi dje një financim prej 7.3 milionë Euro nga IBRD për Projektin e Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri, nga i cili do të përfitojnë fermerë, shoqata të pyjeve, grupe dhe individë në 310 komuna rurale dhe në 2980 fshatra të vendit. Kostoja totale e projektit është 16.8 mil-

ionë Euro dhe bashkë-financohet nga njëfond Besimi prej 7.3 milionë Euro nga Qeveria Suedeze dhe njëfond Besimi prej 2.2 milionë Euro nga Global Environmental Facility (GEF). Objektivi i zhvillimit të projektit është që të mbështesë menaxhimin e qendrueshëm të tokës dhe të rrisë...

(Faqe 7)



## Biznesi "pro" vendimit për mos ndryshim të pagës minimale

Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve, si e vetmja organizatë ligjore punëdhënëse në sektorin e rregjimit të përpunimit aktiv dhe eksporteve të veshjeve dhe këpucëve, e

rregjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të rrethit gjyqësor Tiranë, është e kënaqur të deklarojë si më poshtë vijon. Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve (DHKPV)...

(Faqe 5)

Kurset e këmbimit të valutave kryesore kundrejt dollarit amerikan

Banka e Shqipërisë Dt.09.07.2014

Kurset e këmbimit

USD/lek	103.01
Euro/lek	140.21
GBP/lek	176.20
CHF/lek	115.38

Interesat

Depozitat një ditore	4.50 %
Kredia lombard	12.25 %
Kredia një ditore	8.00 %
Marrëveshje riblerje	6.25 %

Financë

## Cani: Të tjera marrëveshje priten me Bankën Botërore

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat shqyrtoi para dy ditësh dy marrëveshjet me vlerë 220 milionë dollarë që synojnë: Zhvillimin e Financave Publike dhe Modernizimin e Sektorit Financiar. Më herët, këto marrëveshje janë firmosur nga ministri i Financave dhe përfaqësuesja e Bankës Botërore në Tiranë, miratuar nga qeveria dhe aktualisht po diskutohen në komisionet e Kuvendit, ndërsa huatë do të akordohen nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Kreditë janë me interes rreth 2%, disa herë më të



buta se sa huatë në tregun rrethësishëm është shënuar një rekord në aspektin e përbushjes...

nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve është shënuar një rekord në aspektin e përbushjes...

(Faqe 4)

## Berati 6 vjet në UNESCO



Në ambjentet e "Qendrës Mesjetare" në qytetin e Beratit, u zhvillua një aktivitet në kuadrin e 8-Korrikut, "Hyrjes së Beratit në UNESCO". 6 vjet më parë, në sesionin e 32 të Komitetit të Trashëgimisë të mbajtur në Kanada, Berati u rregjistrua si sit i Trashëgimisë Botërore. Pas çeljes së aktivitetit me fjalën e rastit të Eugen Kallfani, drejtori i DRKK Berat...

(Faqe 5)

Fokus

## Lidershipi global i SHBA-ve është gërryer

Trajnerët e dinë se asgjë nuk është më e rrezikshme për një ekip të sportit se sa tërheqja në pasivitet për shkak të frikës që të mos bëhet ndonjë gabim, shkruan në fillim të artikullit e përditshmja Washington Post, dhe shton se nëse kjo është për shkak të dëshirës për të qenë në pozicion të liderit, ose për shkak të nervave pas ndonjë pengese, dështimi për të avancuar në mënyrë agresive është pothuajse çdoherë një gabim strategjik. Ajo që është e vërtetë në garat e sportit është po ashtu shumë e vërtetë në jetën e shtetit. Derisa pamturia kurrë nuk është e mirë, kujdesi i tepruar në emër të mirësisë ose përshatshmërisë mund të ketë pasoja të rënda. Shteti kurrë...

(Faqe 8)



# Biznes



Fondi "Besa" ka nënshkruar dje në Tiranë, një marrëveshje huaje me vlerë 6 miliona euro me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, e cila pritet t'i japë një shtysë të re bujqësisë dhe agrobiznesit. Në këtë eveniment ishin të pranishëm Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, z.Edmond Panariti, Zv/Presidenti i Sektorit Bankar pranë Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim z.Mustafa Boran, Drejtori Ekzekutiv i Fondit "Besa" z.Bajram Muça, etj.

**Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim:**

## 6 milionë euro për Fondin "Besa", mbështetje për SME

Në një konferencë për mediat, presidenti i këtij Fondit "Besa" z.Bajram Muça u shpreh se ky fond është i vendosur të rrisë më tej aktivitetin si dhe të vazhdojë të financojë për zhvillimin e zonave rurale. "Ne kemi arritur një performancë të lartë duke rritur aktivitetin. Do përmblisim të gjitha detyrimet nga kjo marrëveshje, shpresojmë që të jetë një fillim i mbarë pasi do vazhdojmë të investojmë për zhvillimin e zonave rurale dhe të pazhvilluara", tha ai. "Fale një administrimi të shkëlqyer të portofolit të kredise, njohjes së mirë të segmentit të tregut ku operojmë, menazhimit profesional dhe bashkëpunimit efektiv me institucionet vendase dhe të huaja, Fondi Besa sh.a. ka arritur rezultate të shkëlqyera duke u bërë një nga aktorët më të rëndësishëm në sektorin mikrofinanciar shqiptar. Edhe në vitet e fundit të krizës financiare Fondi Besa tregoi performancë të lartë duke rritur aktivitetin dhe duke siguruar mbështetje financiare në vazhdimësi nga institucione të ndryshme pres-

**N E BIZNESEVE MIKRO DHE SME  
T FOR MICRO AND SME-s**



tigoze, siç është edhe Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim", tha Muça.

I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së huasë, Ministri i Bujqësisë, Zhvil-

limit Rural dhe Administrimit të Ujrave, z.Edmond Panariti, tha se kjo hua do i japë një shtyrë për më shumë ritje sektorit të bujqësisë. "Kjo hua që i akordohet fondit Besa do përdoret për të financ-

uar për mikrokredi dhe për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, është ndihmë e madhe edhe për bujqësinë. Bujqësia po rritet, e thonë treguesit statistikorë, në një drejtim të pan-

johur më parë, siç është eksporti. Në këtë 5 mujor eksportet e perimeve dhe frutave janë rritur në masën 28% në krahasim me një vit më parë. Pra, ka premisa që nëse ky fond vihet në fund të fermerëve dhe agrobiznesit t'i japë një shtyrë zhvillimit të aktivitetit të tyre", tha ai.

Kurse z.Mustafa Boran, Zv/President i Sektorit Bankar pranë Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim do të ketë një maturim 3 vjeçar dhe do të shërbejë për zhvillimin e agrobiznesit. "Shqipëria është antare dhe akcionere e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim që në themelimin e saj. Banka jonë ka financiar në Shqipëri 12 projekte me vlerë 106 milionë euro. Ne kemi projekte financuese në Bullgari, Rumania, Greqi, Gjeorgji, Armeni, Azerbajxhan, etj.", tha z.Boran.

Fondi BESA sh.a. aktualisht ka rreth 27,000 kliente aktive dhe tepricë kredite rreth 5.4 Miliarde leke dhe ka dhene qe nga fillimi i aktivitetit rreth 115,000 kredi ne vlerë rreth 40 Miliarde leke.

## Biznesi "pro" vendimit për mos ndryshim të pagës minimale

**D**homa Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve, si e vetmja organizatë ligjore punëdhënësish në sektorin e regjimit të përpunimit aktiv dhe eksporteve të veshjeve dhe këpucëve, e regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë të rrethit gjyqësor Tiranë, është e kënaqur të deklarojë simë posthë vijon: Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve dhe Këpucëve (DHKPV) vlerëson qëndrimin e fundit të Qeverisë Shqiptare, të shprehur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të mos ndryshuar pagën minimale për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

DHKPV është shprehur edhe më parë se vendimarrja politike për ndryshimin e përputhshmërisë minimale në shkallë vendit, pa marrë në konsideratë as partneritetin institucional të partnerëve socialë dhe pa shqyrtuar e analizuar asnjë prej sektorëve dhe efektin që paga minimale jepte në secilin prej tyre, nuk i ka shërbyer as sipërmarrjes dhe as qeverisë. Kjo masë administrative në fakt i ka shërbyer më shumë informalletit në fushën e pagave dhe kontributeve. DHKPV, duke vlerësuar këtë sjellje të re

të administratorëve publikë, ju kujton atyre se kanë qënë disa prononcime, analiza dhe produkte profesionale të ofruara në shtyp dhe në tryezat e debatit nga Bordi Drejtues i DHKPV, që kanë bërë të qartë rrugët dhe mundësitë për të arritur edhe objektivat e qeverisë në fushën e regullimit ligjor të pagave. DHKPV është e gatshme dhe e përgatitur të diskutojë me partnerët socialë për përmirësimin e rolit të pagës minimale, për rregullimin e sistemit të pagave në përgjithësi, por edhe për ndërtimin e politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. DHKPV këmbëngul që autoritetet publike duhet të iniciojnë risma të përfshirjes së sipërmarrjes private dhe të sindikalizimit në analiza sociale ekonomike sektoriale. Gjykojmë që koha e një page minimale unike për të gjithë sektorët dhe në nivel kombëtar, është e tejkaluar. Ajo duhet të negociohet për çdo sektor dhe jo të mbetet si deri më sot, si një masë administrative e vendosur me një VKM.

Sipas DHKPV, konsultuar edhe me shumë ekspertë të fushës, rishikimi politikave të pagave, prazgjedhja e modelit të taksimit të pagës, duhet të ndjekë njërin nga pesë skenarët e mëposhtëm: i) Heqja e pagës minimale

kombëtare dhe zëvendësimi i saj me pagën minimale sipas sektorëve, të negociuar midis punëdhënësve dhe punëmarësve. ii) Ky model zbatohet në Austri, Finlandë, Suedi, Danimarkë, Islandë, Norvegji, Zvicër; iii) Ngrija për një periudhë katër vjeçare e aplikimit të pagës minimale, në sektorët,

të cilët gjenerojnë vende pune. Ky është skenari që garanton rritjen e punësimit, mundëson hyrjen në treg të fuqisë punëtore të re në moshë, të pal kualifikuar. Për industrinë tonë kjo masë shërben për rritjen e ndjeshme të të punësuarve. iv) Bllokimi i rritjes së pagës minimale. v) Aplikimi i sh-


kallëzuar pagave minimale vetëm për grup-moshat e reja. v) Decentralizimi dhe diferencimi i pagës minimale sipas territorit dhe nivelit të varfërisë në kontekstet rajonale. DHKPV, si anëtare me të drejtë të plotë në Këshillin Kombëtar të Punës është e gatshme të jetë pjesë e negociatave.

## POLYGRAFSNAB TIRANA- POLYGRAFSNAB SOFIE

**TREGTON LETER GAZETE dhe për libra me çmime nga më të ultat në treg**

1. Letër gazete në rulo 45g/m2, çmimi 510 euro/ton.
2. Letër gazete në rulo 42g/m2, cilësia e parë, çmimi 550 euro/ton.
3. Letër voluminoze për botime librash 70 dhe 80g/m2 me origjinë nga Suedia, cilësia ekstra 780 euro/ton.

**KËTO ÇMIME JANË PA TVSH DHE MALLI NDODHET NË MAGAZINAT TONA NË TIRANË.**



**TELEFONAT:**  
Në Tiranë: 00355 68 20 21 982 Në Sofje- Bullgari 00359 89 990 7500